



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"

Lenda : Kontabiliteti Financiar
Departamenti : Kontabilitet dhe Financa

Msc. Valdrin Misiri

Pejë, Prill 2018

Kontabiliteti Financiar

- Viti II-të, Semestri IV
- Departamenti : KF
- Statusi i lëndes : Obligative
- Javët mësimore: 15 [4 orë ligjerata, 8 orë ushtrime(4 grupe)]
- Mësimdhënëse: Prof.Ass.Dr. Fitim Deari
- Asistent: MSc.Valdrin Misiri
- Orari i ushtrimeve: E hene (G4 – ora 09:45 - 11:15 E4)
- (G3 – ora 13:15 - 14:45 CI)
- (G2 – ora 15:00 - 16:30 CI)
- Orari i ushtrimeve: E marte (G1 – ora 11:30 - 13:00 CI)

- E-mail: valdrin.misiri@unhz.eu
- Website: www.unhz.weebly.com

Objektivat e ligjerates

- Kontabiliteti i dividendit
- Dividendët në kesh të pagueshme
- Ndarja e dividendit në kesh ndërmjet aksioneve të rregullta dhe preferenciale
- Aksionet preferenciale me kushtin jokumulativ
- Aksionet preferenciale me kushtin kumulativ
- Aksionet preferenciale me kushtin kumulativ dhe participues
- Dividendët në aksione

Kontabiliteti i dividendes

- Nga prizmi i korporatës dividendët, përfaqësojnë shpërndarjen e keshit ose të ndonjë pasurie tjetër për aksionarët e vet.
- Kjo pasuri e dedikuar për dividendët, transferohet nga fitimi i mbajtur.
- Për zotëruesit e aksioneve dividendi prezenton normën e kthimit për investimet e bëra në aksione.

Kontabiliteti i dividendes

- Korporatat deklarojnë dhe paguajnë lloje të ndryshme të dividendëve sic janë:
 - Dividendët në kesh
 - Dividendët në aksione
 - Dividendët në pasuri
- Në shumicën e rasteve në praktikë aplikohen dividendët në kesh dhe dividendët në aksione

Dividendët në kesh

- Shpërndarja e keshit prej fitimit të korporatës për aksionarët e vet përfaqeson dividendin në kesh.
- Deklarimi i dividendit kesh, si dhe pagesa e tij, paraprakisht determinohen nga plotësimi i tri kushteve:
 1. Tepricë kreditore e fitimit të mbajtur
 2. Tepricë (suficit) i keshit
 3. Aprovimi legal nga bordi i drejtorëve

Dividendët në kesh

- Teorikisht maksimumi i shpërndarjës së dividendit është i mundur për atë shumë sa është saldo e fitimit të mbajtur (në praktikë 30-50% të fitimit të mbajtur).
- Kushti tjetër, i cili duhet përmbushur për t'u deklaruar dividenda në kesh, lidhet me suficitin e keshit (situata e kënaqshme e keshit)
- Këshilli i drejtorëve të korporatës është autoriteti kryesor i cili percakton shumën e fitimit të mbajtur që duhet të ndahet për dividendët.

Tri data të rëndësishme për regjistrim kontabël të dividendit të kesh

- **Data e deklarimit**

- Shënon datën në të cilën këshilli i drejtorëve të korporatës e deklaron dividendin, e cila paguhet në një kohë të mëvonshme.

- **Data e regjistrimit**

- Paraqet kohën në të cilën regjistrohen aksionet, të cilat janë në zotërim të aksionarëve.

- **Data e pagesës**

- Paraqet datën në të cilën zotëruesve të aksioneve u paguhet keshi në emër të dividendit.

Tri data të rëndësishme për regjistrim kontabël të dividendit të kesh

- **Data e deklarimit**

- Në datën e deklarimit fitimi i mbajtur debiton për shumën e caktuar dhe krediton dividendi në kesh i paguar.

- **Data e regjistrimit**

- Nuk regjistrohet në kontabilitet.

- **Data e pagesës**

- Në datën e pageses dividendi në kesh i paguar debiton për shumën e caktuar në datën e deklarimit dhe krediton keshi.

Shembull:

- Supozojmë se me 30.06.2017 kompania “A” për 12000 aksione të zakonshme në zotërim ka deklaruar dividend në kesh nga 3€ për aksion e cila pritet të paguhet pas 3 muajve. Me 28.09.2017 kompania “A” ka bërë pagesen e dividendit në kesh të deklaruar me 30.06.2017.
- Bëni regjistrimin kontabel.

Dividendi në aksione

- Korporatat përvec dividendit në kesh, ndonjëherë e deklarojnë edhe dividendin në aksione.
- Dividendët në aksione nënkuptojnë shpërndarjen e aksioneve të reja nga korporata për aksionarët e saj ekzistues
- Deklarimi i dividendës bëhet me një përqindje fikse mbi bazën e numrit të aksioneve në zotërim

Dividendi në aksione

- Dividendi në aksione shpërndahet kryesisht për ndonjëren nga arsyet si në vijim:
 - *Firmat nuk posedojnë suficit keshi për të deklaruar dividendin në kesh.*
 - *Për të ulur cmimin e aksioneve sepse me shpërndarjen e këtij dividendi rritet numri i aksioneve në treg.*
 - *Dividendët në aksione nuk i nënshtrohen tatimit në të ardhura*
- Dividendi në aksione, sikur edhe dividendi në kesh, deklarohet nga këshilli drejtues në një datë të caktuar.

Regjistrimi në kontabilitet sipas lartësisë së % së deklaruar të dividendit në aksione

- **Dividendi në aksione në përqindje të ulët deri në 25%**
- **Dividendi në aksione në përqindje më të lartë se 25%**

Dividendi në aksione në përqindje të ulët deri në 25 %

- **Në datën e deklarimit**

- Në këtë rast kontabilistet rekomandojnë që fitimi i mbajtur si kategori, nga e cila shpërndahet dividendi në aksione, të pakësohet (debiton) për vlerën e tregut të aksionëve të deklaruar si dividend në këtë datë.

- **Në datën e shpërndarjes**

- Debiton llogaria Dividendi në aksionet që duhet shpërndarë dhe krediton llogaria e aksioneve të rregullta

Dividendi në aksione në përqindje të lartë se 25 %

- **Në datën e deklarimit**

- *Fitimi i mbajtur pakësohet për vlerën nominale të aksioneve të deklaruara si dividend. Rekomandimet e kontabilistëve janë të bazuara mbi presupozimet se deklarimi i dividendit në aksione në shuma të vogla nuk ndikon në cmimin e tregut, ndryshe nga ajo kur dividendi deklarohet në % të larta të cilat e ulin cmimin e aksioneve.*

- **Në datën e shpërndarjes**

- *Debiton llogaria Dividendi në aksionet që duhet shpërndarë dhe krediton llogaria e aksioneve të rregullta*

Shembull

- Me 03.04.2017 kompania “S” ka në zotërim të aksionarëve të saj 5000 aksione të zakonshme të vlerës nominale 5€. Në këtë datë kompania “S” ka deklaruar dividendë në aksione ndaj totalit të aksionëve në zotërim dhe se vlera e tregut të këtyre aksioneve është 8€. Këto aksione pritet të shpërndahen si dividendë pas 2 muajve. Me 05.06.2017 kompania “S” ka bërë shpërndarjen e dividendit në aksionet të deklaruar me 03.04.2017.

Ndarja e dividendit në kesh ndërmjet aksioneve të rregullta dhe preferenciale

- Aksionet e preferenciale, në krahasim me aksionet e rregullta kanë prioritet në pagesat e dividendit.
- Prandaj, korporatat të cilat kanë emertuar lloje të ndryshme të aksioneve, duhet të ndajnë dividendin e deklaruar për secilen klasë të aksioneve mbi bazën e preferencave të përcaktuara më parë.

Ndarja e dividendit në kesh ndërmjet aksioneve të rregullta dhe preferenciale

- Për dallim nga aksionet e rregullta, aksionet preferenciale mund të posedojnë tri kushte:
 - *Kushtin jokumulativ*
 - *Kushtin kumulativ*
 - *Kushtin kumulativ dhe participues*
- Dividendët nuk konsiderohen shpenzime të periudhës, ato në kuptimin praktik trajtohen si shpërndarje e fitimit të mbajtur të korporatës.

Shembull

- Supozojmë se me 30.12.2017 kompania “B” ka në zotërim 10.000 aksione preferenciale të vlerës nominale 10€ dhe dividend fikse 8% dhe 40.000 aksione të zakonshme të vlerës nominale 5€. Kompania “B” nuk ka deklaruar dividend në kesh për aksionarët e saj për vitin 2015 dhe 2016, por në vitin 2017 ka deklaruar dividendë në kesh prej 70.000€. Supozojmë se aksionet preferenciale e posedojnë kushtin si vijon:
 - Kushtin jokumulativ (prioritarë)
 - Kushtin kumulativ
 - Kushtin kumulativ dhe participues.

Pyetje



Suksese!